

Komente dhe Shënime Sqaruese për Draft Matricën e Konvertimit

* Për BP dhe PIN, matrica e konvertimit përputhet me komponentet standarde dhe detajet shtesë të *BPM5* (Manualit të Bilancit të Pagesave versioni 5) me komponentet standarde dhe Zërat e tjerë bilancor të zgjedhur të *BPM6* (Manualit të Bilancit të Pagesave versioni 6), shih:

- *BPM5* Bilanci i Pagesave (BP): Komponentet Standarde, f. 43-48;
- *BPM5* Tabelat 7 dhe 8, Bilanci i Pagesave: Komponentet Standarde dhe detajet shtesë;
- *BPM5* Pozicioni i Investimeve Ndërkombëtare (PIN): Komponentet Standarde, f. 108-111;
- *BPM5* Tabela 9, Pozicioni i Investimeve Ndërkombëtare: Komponentet Standarde dhe detajet shtesë;
- *BPM6* Shtojca 9 Komponentet standarde dhe zërat e tjerë bilancor të përzgjedhur.

* Kolona e komenteve në matricën e konvertimit jep shpjegime dhe informata shtesë në lidhje me ndryshimet në mes të *BPM5* dhe *BPM6*. Për të shtuar qartësinë, titujt e komponenteve standarde të *BPM5* janë treguar me shkronja kursive në komente.

* Matrica e konvertimit bazohet në komponentet standarde dhe zërat tjerë të përzgjedhur të *BPM6*. Në një numër të rasteve, renditja e zërave bilancor të *BPM5* është rregulluar për të lehtësuar ndërlidhjen.

* Në matricën e konvertimit, zërat bilancor përkatës të *BPM5* dhe *BPM6* janë të ndërlidhur përmes shigjetave. Me qëllim që të reduktohet ngatërimi, janë përzgjedhur fonte të ndryshme për shigjetat kryqëzuese në rastet kur kryqëzohen shigjetat që nuk korrespondojnë mes vete.

* Në rastet kur zëri bilancor i *BPM5* është nën kategorizuar edhe më tutje në *BPM6*, shigjetat me vija ndarëse përdoren për të ndërlidhur të gjithë zërat bilancor të ri më atë të vjetrin. Shigjetat e ndara përdoren gjithashtu edhe kur *BPM6* tregon jo vetëm zërin bilancor origjinal të *BPM5*, por edhe një zë bilancor 'prej tyre' i cili nuk ishte përfshirë në *BPM5*. Për hir të qartësisë, në këto raste janë përdorur fonte të ndryshme për të dalluar zërin bilancor 'prej tyre'.

NDRYSHIMET NË TRAJTIM OSE KLASIFIKIME NË BPM6			
Zërat bilancor të BP-së			
BPM6 Bilanci i Pagesave: Komponentet standarde dhe Zërat Tjerë të përzgjedhur	Ri-kategorizimi	BPM5 Bilanci i Pagesave: Komponentet Standarde dhe detajet shtesë	Komente mbi Ndryshimet në Trajtim ose Sqarime
Zërat bilancor në shkronja kursive janë plotësues		Zërat bilancor në shkronja kursive janë plotësues	
Llogaria rrjedhëse		1. Llogaria rrjedhëse	
Mallrat dhe shërbimet (P6/P7)		A. Mallrat dhe shërbimet	
Mallrat (P61/P71)		a. Mallrat	* Në BPM6, Mallrat për përpunim dhe Riparimet e mallrave janë të regjistruar te Shërbimet, ndryshe nga BPM5 ku këta zëra bilancor regjistroheshin te mallrat.
Mallra të përgjithshme mbi bazën e bilancit të pagesave Prej të cilave ri-eksportet		1. Mallrat e përgjithshëm 4. Mallra e blera në porte nga bartësit	* BPM6 përfshinë një tabelë të harmonizimit për të treguar marrëdhënien ndërmjet statistikave të tregtisë së mallrave dhe mallrave në bazë të BP-së; shih BPM6 Tabelën 10.2. * Në BPM6, gjësendet personale të emigrantëve nuk klasifikohen si transaksione si në BPM5 dhe kështu nuk janë më të përfshira në mallra, e as diku tjetër në llogaritë ndërkombëtare, shih BPM6 10.22 (b). * Në BPM6, mallrat e blera jashtë vendit për përdorim personal apo për shitje të mëtutjeshme që tejkalojnë kufirin doganor janë të përfshira në mallra të përgjithshme; shih BPM6 10.20. Në BPM5, këto mallra regjistrohen te shpenzimet e udhëtimit; shih BPM5 212 dhe 250. * Në BPM6, mallrat e përgjithshme përfshijnë mallrat e blera në porte, të cilat në BPM5 klasifikohen veçmas; shih BPM6 10.17 (d). * Për dallim nga BPM5, Ri-eksportet, që janë mallra të prodhuara në ekonomitë e tjera dhe më parë të importuara, të cilat eksportohen pa një transformim të konsiderueshëm, duhet të regjistrohen ndaras në qoftë se ato janë pjesë e konsiderueshme e eksporteve; shih BPM6 10,37-10,40.
Eksporti neto i mallrave në tregtinë transit Mallrat e blera nga tregtia transit (eksportet negative) Mallrat e shitura si nënkategori e tregtisë së mallrave		9. Shërbimet tjera biznesore 9.1 Tregtia dhe shërbime të tjera lidhur me tregtinë (pjesërisht; shih më poshtë për shërbimet e tjera lidhur me tregtinë)	* Tregtia e mallrave është e përfshirë te eksportet e mallrave (bruto / neto); shih BPM6 10,41-10,49. Në BPM5, tregtia është e përfshirë në 9.1 te Tregtia dhe shërbimet e tjera të lidhura tregtare. Kur këto mallra mbahen në inventar nga një periudhë në tjetrën, BPM5 rekomandon që blerjet të regjistrohen si importe, dhe shitjet pasuese si importe negative të mallrave. Në këtë rast, çdo diferencë midis vlerës së mallit në momentin e blerjes dhe vlerës në momentin e shitjes futur nën zërin Tregti dhe shërbime tjera të lidhura tregtare; shih BPM5 207, 213 dhe 262. Në BPM6, blerja e mallit klasifikohet si eksport negativ i mallrave të ekonomisë së tregtarit, dhe shitja është një eksport pozitiv i mallrave, me dallim në mes të shitjeve dhe blerjeve të regjistruara si 'eksporte neto të mallrave nën tregtinë transit'.
Ari jo-monetar		5. Ari jo-monetar 5.1 I mbajtur si rezervë 5.2 Të tjera (pjesërisht)	
Shërbimet (P72/P82)			
Shërbimet e prodhimit mbi burimet fizike në pronësi të tjerëve Mallrat për përpunim në ekonominë raportuese - Mallrat e kthyera (CR), Mallrat e pranuar (DR) Mallrat për përpunim jashtë vendit - Mallrat e dërguara (CR), Mallra e kthyera (DR)		2. Mallrat për përpunim	* Në BPM6, pagesa e marrë për shërbimet e ofruara të përpunimit përfshihet në shërbimet e prodhimit në burimet fizike në pronësi të tjerëve; raportimi bruto është plotësues; shih BPM6 10,62-10,71. Në BPM5, mallrat e dërguara jashtë vendit për shërbime të prodhimit janë të përfshira në mallra për përpunim dhe njëkohësisht regjistrohet ndryshimi i pronësisë, përveç nën rrethana të caktuara; shih BPM5 199. Në BPM6, të hyrat e regjistruara të llogarisë financiare për kredi tregtare të kërkuara nga regjistrimet hyrëse për "mallrat për përpunim" nuk janë më të nevojshme.
Shërbimet e mirëmbajtjes dhe riparimit (që nuk janë të përfshira diku tjetër).		3. Riparimet në mallra 1.3.3. Mënyrat tjera të transportit / Të tjera (pjesërisht)	* Në BPM5 zërit bilancor Riparimet në mallra i është ndryshuar emri në Shërbimet e mirëmbajtjes dhe riparimit (që nuk janë të përfshira diku tjetër). Ndryshe nga BPM5, ky zë bilancor përfshihet te shërbimet, në vend të mallrave. Kjo përmban Mirëmbajtjen e mjeteve të transportit, e cila ishte regjistruar në Transporte të tjera, në BPM5; shih BPM6 10,72-10,73 dhe BPM5 200 dhe 240.

NDRYSHIMET NË TRAJTIM OSE KLASIFIKIME NË BPM6			
Zërat bilancor të BP-së			
BPM6 Bilanci i Pagesave: Komponentet standarde dhe Zërat Tjerë të përzgjedhur	Ri- kategorizimi	BPM5 Bilanci i Pagesave: Komponentet Standarde dhe detajet shitesë Zërat bilancor në shkronja kursive janë plotësues	Komente mbi Ndryshimet në Trajtim ose Sqarime
Zërat bilancor në shkronja kursive janë plotësues			
Shërbimet (P72/P82) (vazhdim)			
Transporti* ¹		1. Transporti	* Zëri bilancor <i>Shërbimet e transportit</i> është riemëruar (<i>BPM5: Transportimi</i>) në përputhje me KPC; shih <i>BPM6 10.61</i> .
Transporti detar Transporti i udhëtarëve <i>Nga të cilat: e pagueshme nga punëtorët ndërkufitar (punëtorët që kalojnë kufirin e vendit), sezonal, dhe punëtorët e tjerë afatshkurtër</i> Transport i mallrave Të tjera		1.1 Transporti detar 1.1.1 Transporti i udhëtarëve 1.1.2 Transport i mallrave 1.1.3 Të tjera	* Ky zë bilancor shitesë është i nevojshëm për hartimin e remitancave personale; shih <i>BPM6 12.27 (a)</i> dhe Ap. 5.
Transporti ajror Transporti i udhëtarëve <i>Nga të cilat: e pagueshme nga punëtorët ndërkufitar, sezonal, dhe punëtorët e tjerë afatshkurtër</i> Transport i mallrave Të tjera		1.2 Transporti ajror 1.2.1 Transporti i udhëtarëve 1.2.2 Transport i mallrave 1.2.3 Të tjera	* Ky zë bilancor shitesë është i nevojshëm për hartimin e remitancave personale; shih <i>BPM6 12.27 (a)</i> dhe Ap. 5.
Mënyrat e tjera të transportit Transporti i udhëtarëve <i>Nga të cilat: e pagueshme nga punëtorët ndërkufitar, sezonal, dhe punëtorët e tjerë afatshkurtër</i> Transport i mallrave Të tjera		1.3 Transportet tjera 1.3.1 Transporti i udhëtarëve 1.3.2 Transport i mallrave 1.3.3 Të tjera (pjesërisht)	* Ky zë bilancor shitesë është i nevojshëm për hartimin e remitancave personale; shih <i>BPM6 12.27 (a)</i> dhe Ap. 5. * Në <i>BPM5</i> , 1.3.3 <i>Shërbimet tjera të transportit / Të tjera</i> përfshijnë mirëmbajtjen e pajisjeve të transportit; shih <i>BPM5 240</i> . Në <i>BPM6</i> , mirëmbajtja e mjeteve të transportit është e përfshirë nën shërbimet e mirëmbajtjes dhe riparimit (që nuk janë të përfshira diku tjetër); shih <i>BPM6 10.72</i> .
Shërbimet postare		3. Shërbimet e komunikimit (pjesërisht)	* Në <i>BPM5</i> , shërbimet postare janë të përfshira në Shërbimet, 3. Shërbimet e komunikimit. Në <i>BPM6</i> , ajo është e përfshirë në shërbimet/transporti, shih <i>BPM6 10.74, 10.82-10.85</i> .
Për të gjitha llojet e transportit* ² Transporti i udhëtarëve <i>Nga të cilat: e pagueshme nga punëtorët ndërkufitar, sezonal, dhe punëtorët e tjerë afatshkurtër</i> Transport i mallrave Të tjera			* Ky zë bilancor shitesë është i nevojshëm për hartimin e remitancave personale; shih <i>BPM6 12.27 (a)</i> dhe Ap. 5.
Udhëtimi		2. Udhëtimi	
Biznes <i>Blerja e mallrave dhe shërbimeve nga punëtorët ndërkufitar, sezonal, dhe punëtorët e tjerë afatshkurtër</i> Të tjera		2.1 Biznesor	* Ky zë bilancor shitesë është i nevojshëm për hartimin e remitancave personale; shih <i>BPM6 12.27 (a)</i> dhe Ap. 5.

NDRYSHIMET NË TRAJTIM OSE KLASIFIKIME NË BPM5			
Zërat bilancor të BP-së			
BPM6 Bilanci i Pagesave: Komponentet standarde dhe Zërat Tjerë të përzgjedhur	Ri- kategorizimi	BPM5 Bilanci i Pagesave: Komponentet Standarde dhe detajet shitesë Zërat bilancor në shkronja kursive janë plotësues	Komente mbi Ndryshimet në Trajtim ose Sqarime
Zërat bilancor në shkronja kursive janë plotësues			
Shërbimet (P72/P82) (vazhdim)			
Personale <i>Shërbimet shëndetësore</i> <i>Shërbimet arsimore</i> <i>Të tjera</i>		2.2 Personale 2.2.1 <i>Shërbimet shëndetësore</i> 2.2.2 <i>Shërbimet arsimore</i> 2.2.3 <i>Të tjera</i>	* Regjistrimi i marrëveshjeve alternative për kohën e shkëmbimit (qoftë si investim direkt apo investim tjetër/ kredi tregtare, me kundër rrjedha periodike në shërbimet e akomodimit në udhëtim) është shpjeguar; shih <i>BPM6 10.100</i> dhe <i>Tabelën 10.3</i> . <i>BPM5</i> nuk ka diskutuar marrëveshjet kohore, por përshkrimi në <i>BPM6</i> është në përputhje me parimet e përgjithshme të <i>BPM5</i> . * Në <i>BPM6</i> , mallrat e blera jashtë vendit për përdorim personal apo për shitje të mëtutjeshme që tejkalojnë kufirin doganor janë të përfshira në mallra të përgjithshme; shih <i>BPM6 10.20</i> . Në <i>BPM5</i> , këto mallra janë të përfshira në shërbimet e udhëtimit.
<i>Si për udhëtim biznesor ashtu edhe personal</i> <i>Mallrat</i> <i>Shërbimet e transportit lokal</i> <i>Shërbimet e akomodimit</i> <i>Shërbimet e ushqimit</i> <i>Shërbimet tjera</i> <i>Prej të cilave</i> <i>Shërbimet shëndetësore</i> <i>Shërbimet e arsimore</i>			Ky kategorizim plotësues i udhëtimit lejon lidhje më të ngushtë me llogaritë e ndara të turizmit si dhe me tabelat e furnizimit dhe përdorimit personal <i>BPM6 10.95</i> .
Shërbimet e ndërtimit <i>Shërbimet e ndërtimit jashtë vendit</i> * ³ <i>Shërbimet e ndërtimit në ekonominë raportuese</i> * ³		4. Shërbimet e ndërtimit 9. Shërbime të tjera biznesore (pjesërisht)	* Zërat e veçantë bilancor Shërbimet e ndërtimit jashtë vendit dhe Shërbimet e ndërtimit në ekonominë raportuese janë prezantuar si zëra plotësues; shih <i>BPM6 10.105-10.106</i> . Në <i>BPM6</i> , shpenzimet nga ndërmarrjet jo-rezidente të ndërtimit në mallrat lokale janë përfshirë në shërbimet e ndërtimit; shih <i>BPM6 10.102</i> . Në <i>BPM5</i> , ato janë pjesë e shërbimeve të tjera të biznesit (shih <i>BPM5 254</i>). Si në <i>BPM5</i> , mallrat dhe shërbimet e ofruara nga ndërmarrja e ekonomisë vendore e (transaksionet rezident - rezident) duhet të përjashtohen nga mallrat dhe/ose shërbimet e përgjithshme të ekonomisë lokale. Ndryshe nga <i>BPM5</i> , mallrat dhe shërbimet e blera nga ekonomitë e treta janë regjistruar në mallra të përgjithshme dhe / ose shërbime për ekonominë e ndërmarrjes; shih <i>BPM6 10,102</i> .
Shërbimet e sigurimit dhe pensionale * ¹ <i>Sigurimi i drejtpërdrejtë</i> <i>Risigurimi</i> <i>Shërbimet ndihmëse të sigurimit</i> <i>Pensionet dhe shërbimet e standardizuara të garantuara</i>		5. Shërbimet e sigurimit	* Në <i>BPM6</i> , Premiumet shtesë janë marrë parasysh në kalkulimin e shërbimeve të sigurimit; shih <i>BPM6 10.111</i> dhe <i>Shtojcën 6c</i> . <i>BPM5</i> pranon të injorojë këto flukse mbi baza praktike; shih <i>BPM5 257</i> . Në <i>BPM6</i> , risigurimi dhe sigurimi i drejtpërdrejtë trajtohen njësoj. shih <i>BPM6 10,111</i> , ndërsa <i>BPM5</i> rekomandon regjistrimin e bilancit të të gjitha qarkullimeve mes siguruesve rezident dhe ri-siguruesve jo-rezident (dhe anasjelltas) në shërbime; shih <i>BPM5 257</i> . Për dallim nga <i>BPM5</i> , vlerësimi i kërkesave të sigurimit që përdoret për të nxjerrë vlerën e shërbimeve të sigurimit mund të rregullohet për të marrë parasysh paqëndrueshmërinë e kërkesës, shih <i>BPM6 10,114 (c)</i> .
Shërbimet Financiare <i>Shërbime financiare të tarifuar direkt dhe shërbime të tjera financiare</i> <i>Shërbimet e ndërmjetësimit financiar të matura indirekt (FISIM)</i>		6. Shërbimet Financiare B.2 Të ardhurat nga investimet (pjesërisht) <i>Tarifimi i ndërmjetësimit financiar i matur indirekt</i>	*Tarifat e nënkuptuara të tregtarëve financiar nëpërmjet margjinave janë të përfshira në shërbimet financiare; shih <i>BPM6 10,119</i> . Në <i>BPM5</i> , margjinat e nënkuptuara nuk diskutohen veçmas dhe për këtë arsye mund të përfshihen në flukset financiare. Në <i>BPM6</i> , shërbimet e mbajtësve të aseteve ndaj pronarëve e tyre, ku kostot e menaxhimit të aseteve përjashtohen nga të ardhurat, janë të përfshira në shërbimet financiare; shih <i>BPM6 10,124</i> . Në <i>BPM5</i> , këto shpenzime nuk janë diskutuar ndaras dhe për këtë arsye mund të përfshihen në të ardhurat nga investimet. * <i>BPM6</i> e identifikon FISIM për kredi dhe depozita, kur këto kredi dhe depozita janë dhënë nga, ose janë depozituar me, korporatat financiare (siç është përcaktuar në <i>BPM6 4,63-4,64</i>), shih <i>BPM6 10,127</i> . Në <i>BPM6</i> , FISIM mund t'i atribuohet interesit mbi kredi dhe depozita në investime direkte, investime të tjera, dhe asete rezervë, por jo investimeve të portfolio. Në <i>BPM5</i> , FISIM nuk kategorizohet në shërbimet financiare, shih <i>BPM5 508</i> .

NDRYSHIMET NË TRAJTIM OSE KLASIFIKIME NË <i>BPM6</i>			
Zërat bilancor të BP-së			
<i>BPM6</i> Bilanci i Pagesave: Komponentet standarde dhe Zërat Tjerë të përzgjedhur	Ri- kategorizimi	<i>BPM5</i> Bilanci i Pagesave: Komponentet Standarde dhe detajet shitesë Zërat bilancor në shkronja kursive janë plotësues	Komente mbi Ndryshimet në Trajtim ose Sqarime
Zërat bilancor në shkronja kursive janë plotësues			
Shërbimet (P72/P82) (vazhdim)			
Tarifat për përdorimin e pronësisë intelektuale (që nuk janë të përfshira diku tjetër). ^{*1}		8. Tarifat për të drejtën e autorit dhe licencën	* <i>BPM6</i> përdor titullin Tarifat për përdorimin e pronës intelektuale në vend të tarifës për të drejtën e autorit dhe licencën në <i>BPM5</i> . Ajo përfshijnë tarifat për përdorimin e (i) të drejtave ekskluzive dhe markave tregtare, si në <i>BPM5</i> ; dhe (ii) rezultatet e K&ZH (Kërkimit dhe Zhvillimit). Në <i>BPM6</i> , si në <i>BPM5</i> , blerjet/shitjet e drejtpërdrejta të drejtave ekskluzive dhe markave tregtare janë regjistruar në llogarinë kapitale. Tarifat për shfrytëzimin e pronës intelektuale gjithashtu përfshijnë licencat për të riprodhuar dhe/ose shpërndarë (i) softuer; dhe (ii) shërbime audiovizuale dhe shërbime të tjera të ngjashme, (<i>BPM5</i> nuk është e qartë në regjistrimin e licencave për të riprodhuar dhe/apo shpërndarë). Shih <i>BPM6</i> 10.137 - 10.140 dhe <i>Tabelën 10.4</i> .
Shërbimet kompjuterike, informative, dhe të telekomunikacionit ^{*1} <i>Shërbimet e telekomunikacionit</i>		3. Shërbimet e komunikimit (pjesërisht)	* Në <i>BPM6</i> , shërbimet e telekomunikacionit, kompjuterike, dhe të informacionit futen në të njëjtin grup (shih <i>BPM6</i> 10.141). Kjo përfshinë zërat bilancor vijues të <i>BPM5</i> : (i) 3. Shërbimet e komunikimit (me përjashtim të shërbimeve postare, të cilat janë të regjistruara nën Transport në <i>BPM6</i>); dhe (ii) 7. Shërbimet kompjuterike dhe të informacionit.
<i>Shërbimet kompjuterike</i> <i>Shërbimet informative</i>		7. Shërbimet kompjuterike dhe informative	* Në <i>BPM6</i> , Shërbimet kompjuterike përfshijnë (i) licencat për të përdorur softuerin; dhe (ii) blerjet/shitjet e drejtpërdrejta të softuerit. Shërbimet kompjuterike nuk përfshijnë (i) licencat për të riprodhuar dhe/ose shpërndarë softuerin (shih Tarifat për përdorim të pronësisë intelektuale; <i>BPM6</i> 10.137 (b)); dhe (ii) transaksionet në softuer të pa modifikuara (të prodhuara në masë) të ofruara në media fizike me të drejtë për përdorim të përhershëm, të cilat duhet të regjistrohen tek mallrat (kjo e fundit nuk është ndryshim, por sqarim për <i>BPM5</i>). shih <i>BPM6</i> 10.143 dhe <i>Tabelën 10.4</i> .
Shërbime tjera biznesore ^{*1}		9. Shërbime tjera biznesore	
Shërbimet e Kërkimit dhe Zhvillimit (K&ZH)		2. Llogaria kapitale dhe financiare 2.A.2. Përvetësimi/ shitja e aseteve jo-prodhuese dhe jofinanciare, (pjesërisht)	* Në <i>BPM6</i> , rezultatet e K&ZH konsiderohen asete të prodhuara. Blerjet dhe shitjet e drejtpërdrejta të rezultateve të K&ZH për këtë arsye janë të regjistruara në shërbimet e kërkimit dhe zhvillimit; shih <i>BPM6</i> 10.147-10.148. Në <i>BPM5</i> , shitjet dhe blerjet e rezultateve të K&ZH janë të regjistruara në llogarinë e kapitale/asetet jo-financiare jo prodhuese; shih <i>BPM5</i> 358. Në <i>BPM6</i> , tarifat për përdorimin e rezultateve të K&ZH janë të përfshira në tarifat për përdorimin e pronës intelektuale. Në <i>BPM5</i> , ofrimi i shërbimeve K&ZH është i përfshirë nën kategorinë shërbimet e ndryshme biznesore, profesionale dhe teknike 9.3; shih <i>BPM5</i> 264.
Shërbimet këshilluese profesionale dhe të menaxhimit Shërbimet teknike, lidhur me tregtinë, dhe shërbimet e tjera biznesore		9.1 Tregtia dhe të tjerat të ndërlidhura me tregtinë 9.2 Shërbimet operacionale të lizingut 9.3 Shërbimet e ndryshme biznesore, profesionale, dhe teknike	* Në <i>BPM6</i> , tregtia është regjistruar te kategoria Mallrat/eksportet neto të mallrave nën tregtinë, Ndryshe nga shërbimet në <i>BPM5</i> ; shih <i>BPM6</i> 10.41-10.49.
Shërbimet personale, kulturore, dhe rekreative ^{*1}		10. Shërbimet personale, kulturore, dhe rekreative	
Shërbimet audiovizuale dhe të ngjashme me to		10.1 Shërbimet audiovizuale dhe të ngjashme me to	* Në <i>BPM6</i> , Shërbimet Audiovizuale dhe të ngjashme me to, dhe shërbimet e tjera personale, kulturore dhe rekreative përfshijnë (i) licencat për përdorimin e produkteve dhe (ii) blerjet/shitjet e drejtpërdrejta. Shërbimet audiovizuale dhe të ngjashme me to nuk përfshijnë (i) licencat për të riprodhuar dhe / ose shpërndarë (shih tarifat për përdorimin e pronës intelektuale); dhe (ii) transaksionet në produktet e pa-modifikuara (prodhuara në masë) të ofruara në disqe, etj, të cilat duhet të jenë të regjistruara nën mallra(ky nuk është ndryshim, por sqarim për <i>BPM5</i>). Shih <i>BPM6</i> 10.162-10.166 dhe <i>Tabelën 10.4</i> .

NDRYSHIMET NË TRAJTIM OSE KLASIFIKIME NË BPM6			
Zërat bilancor të BP-së			
BPM6 Bilanci i Pagesave: Komponentet standarde dhe Zërat Tjerë të përzgjedhur	Ri- kategorizimi	BPM5 Bilanci i Pagesave: Komponentet Standarde dhe detajet shitesë Zërat bilancor në shkronja kursive janë plotësues	Komente mbi Ndryshimet në Trajtim ose Sqarime
Zërat bilancor në shkronja kursive janë plotësues		Zërat bilancor në shkronja kursive janë plotësues	
Shërbimet (P72/P82) (vazhdim)			
Shërbimet e tjera personale, kulturore dhe rekreative	←	10.2 Shërbimet e tjera personale, kulturore dhe rekreative	* BPM6 përshkruan tarifën e shërbimit të lotarive dhe lojërave të fatit si diferencë midis tarifave të lojërave të fatit dhe fitimit e pagueshme nga operatori. Tarifa e shërbimit është e përfshirë në bazë të shërbimeve të tjera personale, kulturore dhe rekreative, shih BPM6 10,170. Fitimet e pagueshme ndërmjet operatorit dhe pjesëmarrësve regjistrohen në kuadër të transfereve personale; shih BPM6 12.25-12.26. BPM5 diskuton vetëm mbi regjistrimin e lojërave të fatit në aspektin e transfereve të tjera rrjedhëse; shih BPM5 303. Lojërat e fatit nga vizitorët jashtë vendit (nuk diskutohen në BPM5) duhet të përfshihen në shërbimet e udhëtimit, shih BPM6 10.88.
Mallrat dhe shërbimet qeveritare (që nuk janë të përfshira diku tjetër). ^{*1} Shërbimet lidhur me turizmin dhe transportin e pasagjerëve	←	11. Shërbimet qeveritare (që nuk janë të përfshira diku tjetër).	Ky zë bilancor plotësues lejon për lidhjen me llogaritë e ndara të turizmit, si dhe me tabelat e furnizimit dhe përdorimit BPM6 10.95.
Të ardhurat primare: Komentet e përgjithshme			
* Termi të ardhurat primare është prezantuar në BPM6 që të jetë në përputhje me SNA 2008 (Sistemi i Llogarive Kombëtare); shih BPM6 11.1. Qiraja dhe tatimet/subvencionet mbi produktet dhe prodhimin janë të përfshira në mënyrë eksplicite në të ardhurat primare, shih BPM6 tabelat 11.1, 11.2, dhe 11.3.			
* Kompensimi i punëtorëve. Marrëdhënia punëdhënës-punëtor është sqaruar për të bërë dallimin mes kompensimit të punëtorëve dhe pagesës për shërbime në BPM6 11.12. Ky është një sqarim për BPM5 dhe në përputhje me parimet e saj të përgjithshme. Megjithatë, ajo mund të rezultojë në ri-klasifikimet që përfshijnë kompensimin e punëtorëve dhe shërbimeve.			
* Dividendat. Në BPM6, dividendët regjistrohen kur aksionet konsiderohen ex –dividentë; shih BPM6 3.48; në BPM5: kur janë të pagueshme; shih BPM5 282, 284. Tërheqjet e të ardhurave nga kuazi-korporatat regjistrohen kur të tërhiqen, në përputhje me parimet e BPM5; shih BPM6 11.31. BPM6 përshkruan super-dividendët, të cilët duhet të regjistrohen si tërheqje të kapitalit, jo si të ardhura primare; shih BPM6, 11.27. Termi 'super-dividendët' nuk është diskutuar në BPM5, por trajtimi në BPM6 është në përputhje me parimet e përgjithshme të BPM5 (sidomos dividendët likuidues; shih BPM5 290). Në BPM6, titulli Të ardhurat nga kuazi-korporatat zëvendëson termin e BPM5 fitimet e shpërndara të degës, shih BPM6 11.26. Janë sqaruar aranzhimet për çmimin e transferit (që mund të rezultojë në një kundër ndërhyrje në dividendë ose rrjedhë të kapitalit); shih BPM6 11,101-11,102. Ky sqarim nuk është ndryshim nga BPM5; shih BPM5 97-103.			
* Interesi. Në BPM6, të ardhurat nga interesi janë rregulluar për të treguar interes 'të pastër', d.m.th komponenti FISIM është i përfshirë në shërbimet financiare; shih BPM6 11,74-75. BPM6 identifikon FISIM për kredi dhe depozita, kur këto kredi dhe depozita janë të ofruara nga, ose depozitohen në, korporatat financiare (siç është përcaktuar në BPM6 4.64); shih BPM6 10,127. FISIM mund t'i atribuohet interesit për kredi dhe depozita në të ardhurat e investuese direkte, të ardhurave të tjera nga investimet, dhe asetet rezervë, por jo investimet portofolio. BPM5 nuk e identifikon FISIM; shih BPM5 pjesa 258, shënimi 7. Megjithatë, ajo është përfshirë si detaj shtesë në BPM5 Tabelën 7 që të mundëson barazimin me SNA.			
* Asetet rezervë. Në BPM6, të ardhurat nga asetet rezervë identifikohen veçmas. Nëse nuk janë në dispozicion për publikim, të ardhurat nga asetet rezervë mund të përfshihen në investime/interesa të tjera; shih BPM6 11,109. Në BPM5, të ardhurat nga asetet rezervë janë përfshirë në të ardhurat e investimeve të tjera; shih BPM5 281.			
* Taksat nga huadhëniet e letrave me vlerë dhe kredive në ari. Në BPM6, taksat nga huadhëniet e letrave me vlerë dhe kredive në ari janë sqaruar dhe trajtuar si interes nëse taksat rriten për pronarin që i jep hua këto pasuri (shih BPM6 11,67-11,68) me kundër-hyrje në llogari të tjera të pranueshme/të pagueshme; shih BPM6 5.73. BPM5 nuk diskuton këto tarifa në mënyrë eksplicite. Si në BPM5, taksat e pagueshme për kujdestarët etj., shërbimet administrative që lidhen me huadhënien regjistrohen në shërbimet financiare.			
Të ardhurat primare		B. Të ardhurat	
Kompensimi i punëtorëve (D1)	←	1. Kompensimi i punëtorëve	* Shih të ardhurat primare, komente të përgjithshme: kompensimi i punëtorëve.
Të ardhurat nga investimet		2. Të ardhurat nga investimet	
Investimet direkte		2.1 Investimet direkte	
Të ardhurat nga kapitali dhe investimet në aksione	←	2.1.1 Të ardhurat nga kapitali	* Për dallim nga BPM5, të ardhurat nga investimet direkte janë ndarë varësisht nga lloji i marrëdhënieve të IHD-ve; shih BPM6 6.37.
Dividentat dhe tërheqjet nga të ardhurat e kuazi-korporatave (D42D)		2.1.1.1 Dividenda dhe fitimi e shpërndara degëve	* Shih të ardhurat primare, komentet e përgjithshme: dividendët nga investimet direkte.
Investitori direkt në ndërmarrjen investuese direkte			
Ndërmarrja investuese direkte në investitorin direkt (investimet e anasjellta)			

NDRYSHIMET NË TRAJTIM OSE KLASIFIKIME në BPM6			
Zërat bilancor të BP-së			
BPM6 Bilanci i Pagesave: Komponentet standarde dhe Zërat Tjerë të përzgjedhur	Ri- kategorizimi	BPM5 Bilanci i Pagesave: Komponentet Standarde dhe detajet shtesë Zërat bilancor në shkronja kursive janë plotësues	Komente mbi Ndryshimet në Trajtim ose Sqarime
Zërat bilancor në shkronja kursive janë plotësues			
Të ardhurat primare (vazhdim)		B. Të ardhurat	
Ndërmjet ndërmarrjeve të ndërlidhura <i>nëse investitori me fuqi vendimmarrëse është rezident</i> <i>nëse investitori i me fuqi vendimmarrëse është jorezidentë</i> <i>nëse investitori me fuqi vendimmarrësi është i panjohur</i>			
Fitimi i ri-investuar (D43D) <i>Të ardhurat nga investimet i atribuohen poseduesve të policave në sigurim, skemave të pensioneve, dhe garancive të standardizuara, dhe në aksionarët e fondit të investimeve (D44D)</i> <i>prej të cilave: Të ardhurat nga investimet i atribuohen aksionarëve të fondit të investimeve (D443D)</i>		2.1.1.2 Fitimi i ri-investuar dhe Fitimi i pashpërndarë degëve	* Në BPM6, titulli Fitim i ri-investuar zëvendëson termin e BPM5 Fitimi i ri-investuar dhe fitimi pashpërndarë degëve, pa ndryshuar përmbajtjen e zërit bilancor.
Interesi (D41D) Investitori direkt në ndërmarrjen investuese direkte Ndërmarrja investuese direkte në investitorin direkt (investimet e anasjellta) Ndërmjet ndërmarrjeve partneret e ndërlidhura <i>nëse investitori me fuqi vendimmarrëse është rezident</i> <i>nëse investitori me fuqi vendimmarrëse është jorezidentë</i> <i>nëse investitori me fuqi vendimmarrëse është i panjohur</i>		2.1.2 Të ardhurat nga borxhi (interesi), (pjesërisht)	* Shih të ardhurat primare, komente të përgjithshme: interesi.
Zëri bilancor Memorandum: Interesi para FISIM-it		2.1.2 Të ardhurat nga borxhi (interesi)	* Në BPM6, 'interesi aktual', d.m.th interesi që përfshinë FISIM, është zë bilancor i quajtur memorandum; shih BPM6 11.74. Ky zë bilancor korrespondon me interes të raportuar në BPM5.
Investimet në letra me vlerë		2.2 Investimet në letra me vlerë	* Shih të ardhurat primare, komente të përgjithshme: interesi.
Të ardhurat nga investimet mbi kapitalin dhe aksionet e fondit të investimeve Dividentat mbi kapitalin pa përfshirë aksionet e fondit të investimeve (D42P) Të ardhurat nga investimet i atribuohen aksionarëve të fondit të investimeve (D443P) Dividentat Fitimi i ri-investuar		2.2.1 Të ardhurat nga kapitali (dividendët) (pjesërisht)	* Shih të ardhurat primare, komente të përgjithshme: dividendët. * Për më tepër në BPM5, fitimi i ri-investuar i fondeve të investimeve përfshihet në të ardhurat primare për investimin portfolio, me zë korrespondues në llogarinë financiare; BPM6 11.37 - 11.39.
Interesi (D41P)		2.2.2 Të ardhurat nga borxhi (interesi) (pjesërisht)	* Shih të ardhurat primare, komente të përgjithshme: interesi dhe tarifat mbi huadhënien e letrave me vlerë dhe kreditë e arit.
Afatshkurtë		2.2.2.2 Instrumentet e tregut të parasë	
Afatgjatë		2.2.2.1 Bonot dhe dëftesat	
		2.2.2.1.2 Interesa të tjera	
		2.2.2.1.1 FISIM	* Për dallim nga BPM6, BPM5 nuk e identifikon FISIM; shih BPM5 pjesa 258, shënimi 7. Megjithatë, ajo është e përfshirë si detaj shtesë në BPM5 Tabelën 7 që të lejojë pajtimin me SNA. BPM6 nuk e identifikon FISIM mbi investimet portfolio.
Investimet tjera		2.3 Investimet tjera	* Shih të ardhurat primare, komente të përgjithshme: interesi, dhe asetet rezervë.

NDRYSHIMET NË TRAJTIM OSE KLASIFIKIME NË BPM6			
Zërat bilancor të BP-së			
BPM6 Bilanci i Pagesave: Komponentet standarde dhe Zërat Tjerë të përzgjedhur	Ri-kategorizimi	BPM5 Bilanci i Pagesave: Komponentet Standarde dhe detajet shtesë Zërat bilancor në shkronja kursive janë plotësues	Komente mbi Ndryshimet në Trajtim ose Sqarime
Zërat bilancor në shkronja kursive janë plotësues		B. Të ardhurat	
Të ardhurat primare (vazhdim)			
Tërheqjet nga të ardhurat e kuazi-korporatave (D420)		<i>Të ardhurat e kapitalit (nuk janë në dispozicion në BPM5)</i>	* Në BPM6, të ardhurat nga kapitali që nuk janë të përfshira në investime direkte dhe që nuk janë në formë të letrave me vlerë (p.sh. D420) dallohen veçmas nga të ardhurat nga investimet e tjera; shih BPM6 5.26 -5.27. BPM5 nuk e specifikon këtë lloj të kapitalit.
Interesi (D410) Zëri bilancor Memorandum: Interesi para FISIM-it		2.3.2 Interesi tjetër (pjesërisht) 2.3.1 FISIM	* Në BPM6, 'interesi aktual', d.m.th interesi që përfshinë FISIM, është një zë bilancor i quajtur memorandum; shih BPM6 11.74. Ky zë bilancor korrespondon me interesin e raportuar në BPM5.
Të ardhurat nga investimet i atribuohen poseduesve të policave në sigurim, skemave të pensioneve, dhe të garancive të standardizuara (D4410 + D4420)		2.3.3 Të ardhurat e marra nga ekonomitë familjare prej investimeve në sigurimin e jetës dhe në fondet pensionale	* Në BPM6, shtesat e primit janë marrë parasys në llogaritjen e shërbimeve të sigurimit; shih BPM6 10,111 dhe Shtojcën 6c. Kështu, shumat e përgjithshme e të ardhurave nga investimet që i atribuohen poseduesve të policave është klasifikuar si shtesë e primit; shih BPM6 Shtojcën 6c.26. BPM5 pranon të injorojë këto fluxe mbi baza praktike; shih BPM5 257.
Asetet rezervë * ⁴			* Shih të ardhurat primare, komentet e përgjithshme: interesi; taksat mbi huadhënien e letrave me vlerë dhe kredive të arit; dhe asetet rezervë.
Të ardhurat mbi kapitalin fondi i investimeve në aksione (D42R) * ⁴			
Interesi (D41R) * ⁴			
Zëri bilancor Memorandum: Interesi para FISIM-it * ⁴			
Të ardhura tjera primare		C. Transferet rrjedhëse (pjesërisht)	
Taksat mbi prodhim dhe importe (D2) Subvencionet (D3)		1. Qeveria e përgjithshme (pjesërisht) 1.2 Taksa të tjera për prodhim 1.3 Subvencionet tjera mbi prodhim	* Në BPM6, taksat dhe subvencionet mbi produktet dhe prodhimin klasifikohen si të ardhura primare, jo si të ardhura sekondare (transferat rrjedhëse) si në BPM5, shih BPM6 11,91-11,94.
		2. Sektorët e tjerë 2.2 Transferet tjera (pjesërisht) 2.2.2 Taksa tjera për prodhim 2.2.3 Subvencionet tjera mbi prodhim	
Qiraja (D45)			* Në BPM5, qiraja (D45) nuk identifikohet veçmas.
Të ardhurat sekondare: Komentet e përgjithshme			
* Termi të ardhurat sekondare është aplikuar që të jetë në përputhje me SNA dhe është sqaruar në BPM6 12.1-12.4. Llojet më të detajuara të transfereve rrjedhëse janë aplikuar në një bazë shtesë; shih BPM6 12.20. Rikthimet e taksave tek tatimpaguesit trajtohen si taksa negative, pra, shumat e taksave është ulur me rikthimet e taksave; shih BPM6 12.28. Në BPM5, kthimet e taksave regjistrohen në kuadër të transfereve qeveritare; shih BPM5 299. Dallimi në mes të taksave dhe shërbimeve është sqaruar. Licencat e biznesit për peshkim, gjueti, etj., nuk trajtohen më automatikisht si taksa në BPM5, por si shërbime, qira, taksa, apo blerje e një aseti të licencës, në varësi të kthimeve nga këto shërbime; shih BPM6 10,179-180, 12.30; BPM5 300.			
Të ardhurat sekondare		C. Transferet rrjedhëse	
Qeveria e përgjithshme		1. Qeveria e përgjithshme	
Tatimet rrjedhëse në të ardhurat, pasurinë, etj (D5)		1.1 Tatimet rrjedhëse në të ardhurat, pasurinë, etj.	
Nga të cilat: të pagueshme nga punëtorët ndërkufitar, sezonal dhe punëtorët e tjerë afatshkurtër			* Të dhënat plotësuese që lidhen me punësimin ndërkufitar përdoren për të përpiluar remitancat; shih BPM6 12.27.
		1.2 Taksa të tjera për prodhim 1.3 Subvencionet tjera për prodhim	* Në BPM6, taksat dhe subvencionet mbi produktet dhe prodhimin klasifikohen si të ardhura primare; jo si të ardhura sekondare (transferet rrjedhës) si në BPM5; shih BPM6 11,90-11,93.
Kontributet sociale (D61)		1.4 Kontributet sociale	
Nga të cilat: të pagueshme nga punëtorët ndërkufitar, sezonal dhe punëtorët e tjerë afatshkurtër			* Të dhënat plotësuese që lidhen me punësimin ndërkufitar përdoren për të përpiluar remitancat; shih BPM6 12.27.

NDRYSHIMET NË TRAJTIM OSE KLASIFIKIME NË BPM6			
Zërat bilancor të BP-së			
BPM6 Bilanci i Pagesave: Komponentet standarde dhe Zërat Tjerë të përgjedhur	Ri- kategorizimi	BPM5 Bilanci i Pagesave: Komponentet Standarde dhe detajet shitesë Zërat bilancor në shkronja kursive janë plotësues	Komente mbi Ndryshimet në Trajtim ose Sqarime
Zërat bilancor në shkronja kursive janë plotësues			
Të ardhurat sekondare (vazhdim)		C. Transferet rrjedhëse	
<i>Kontributet sociale (D62 + D63)</i>	←	1.5 <i>Kontributet sociale</i>	
<i>Bashkëpunimi ndërkombëtar (D74) Transferet tjera rrjedhëse të qeverisë së përgjithshme (D75)</i>	←	1.6 <i>Transferet tjera rrjedhëse të qeverisë së përgjithshme</i>	
<i>Prej të cilave: Transferet rrjedhëse në OJSHEF-të</i>	←		* Të dhënat plotësuese mbi transferet rrjedhëse në OJSHEF-të janë përdorur për të përpiluar remitancat totale në OJSHEF; shih <i>BPM6 12.27</i> .
Korporatat financiare, korporatat jofinanciare, ekonomitë familjare, dhe OJSHEF-të		2. Sektorët tjerë	
Transferet personale (Transferet rrjedhëse ndërmjet ekonomive familjare rezidente dhe jorezidentë)	←	2.1 Remitanca	* <i>BPM6</i> prezanton konceptin e Transferave personale, e cila është më e gjerë se remitancat (si në <i>BPM5</i> ashtu dhe në <i>BPM6</i>), sepse ajo përfshin gjitha transferet ndërmjet individëve, jo vetëm ato të emigrantëve të cilët janë të punësuar në ekonomitë e reja dhe konsiderohen si rezident; shih <i>BPM6 12.21-12.27</i> dhe <i>Shtojcën 5</i> .
<i>Prej të cilave: Remitanca</i>	←		
Transferet e tjera rrjedhëse <i>Taksat rrjedhëse në të ardhurat, asetet, etj (D5)</i>	←	2.2 Transferet tjera 2.2.1 <i>Tatimet rrjedhëse në të ardhurat, pasurinë, etj</i>	
	←	2.2.2 <i>Taksa të tjera për prodhim</i> 2.2.3 <i>Subvencionet tjera për prodhim</i>	* Në <i>BPM6</i> , taksat dhe subvencionet mbi produktet dhe prodhim klasifikohen si të ardhura primare; jo si të ardhura sekondare (Transferet rrjedhëse) si në <i>BPM5</i> ; shih <i>BPM6 11.91-11.94</i> .
<i>Kontributet sociale (D61) Përfitimet sociale (D62+D63)</i>	←	2.2.4 <i>Kontributet sociale</i> 2.2.5 <i>Përfitimet sociale</i>	
<i>Priemime neto të sigurimit jo-jetë, (D71) Kërkesat e sigurimit jo jetë (D72)</i>	←	2.2.6 <i>Transferet tjera aktuale të sektorëve të tjerë</i>	* Në <i>BPM6</i> , shtesat e primit janë marrë parasysh në kalkulimin e vlerës së shërbimeve të sigurimit; shih <i>BPM6 10.111</i> dhe <i>Shtojcën 6c</i> . <i>BPM5</i> pranon të injorojë këto flukse në baza praktike; shih <i>BPM5 257</i> . Në <i>BPM6</i> , ri-sigurimi dhe sigurimi direkt trajtohen njësoj; shih <i>BPM6 10.111</i> , ndërsa <i>BPM5</i> rekomandon regjistrimin e bilancit të të gjitha flukseve ndërmjet sigurvezës rezident dhe ri-sigurvezës jo-rezident (dhe anasjelltas) në shërbime; shih <i>BPM5 257</i> . Për dallim nga <i>BPM5</i> , vlerësimi i kërkesave të sigurimit të përdorura për të nxjerrë vlerën e shërbimeve të sigurimit mund të rregullohet për të marrë parasysh paqëndrueshmërinë e kërkesës, shih <i>BPM6 10.114 (c)</i> . Për dallim nga <i>BPM5</i> , kërkesat e sigurimit mund të trajtohen si transfere kapitale në raste të veçanta të humbjeve katastrofike për të qenë në pajtim me <i>SNA</i> ; shih <i>BPM6 13.24</i> .
<i>Bashkëpunimi aktual ndërkombëtar (D74)</i>	←		* Asistenca teknike që është pjesë e, ose e lidhur me projektet kapitale (ky zë bilancor nuk diskutohet në mënyrë eksplicite në <i>BPM5</i>) është regjistruar si transfer kapital; shih <i>BPM6 12.50</i> . Transferet e pajisjeve në formë të armëve apo pajisjeve që janë klasifikuar si asete fikse konsiderohen si grante investimi dhe kështu regjistrohen në llogarinë kapitale; shih <i>BPM6 13.26</i> . Në <i>BPM5</i> , këto transfere janë trajtuar si transfere rrjedhëse; shih <i>BPM5 349</i> .
<i>Transferet e ndryshme rrjedhëse (D75) Prej të cilave: Transferet rrjedhëse në OJSHEF-të</i>	←		* Të dhënat plotësuese mbi transferet rrjedhëse në OJSHEF-të janë përdorur për të përpiluar remitancat totale në OJSHEF-të; shih <i>BPM6 12.27</i> .
<i>Rregullimi për ndryshim në të drejtat e pensioneve (D8)</i>	←		* Trajtimi i kontributeve / arkëtimit të pensioneve është në pajtim me <i>SNA 2008</i> dhe zëri bilancor i rregullimit për ndryshim në të drejtat e pensioneve futet në përdorim; shih <i>BPM6 12.38</i> . Kur flukset ndërkufitare janë të vogla, zëri bilancor i rregullimit mund të hiqet; shih <i>BPM6 12.39</i> .

NDRYSHIMET NË TRAJTIM OSE KLASIFIKIME NË BPM6			
Zërat bilancor të BP-së			
BPM6 Bilanci i Pagesave: Komponentët standarde dhe Zërat Tjerë të përzgjedhur	Ri- kategorizimi	BPM5 Bilanci i Pagesave: Komponentët Standard dhe detajet shitesë Zërat bilancor në shkronja kursive janë plotësues	Komente mbi Ndryshimet në Trajtim ose Sqarime
Zërat bilancor në shkronja kursive janë plotësues			
Llogaria kapitale: Komente të përgjithshme			
* Debitë dhe kreditë për blerjen / shitjen e aseteve jo-financiare jo prodhuese duhet të regjistrohen veçmas, jo të regjistrohet vetëm vlera neto si në BPM5; shih <i>BPM6 13.7 dhe 3.113</i> .			
* Ndryshe nga BPM5, të drejtat e emetimit dhe emrat e domenit të internetit janë identifikuar si asete të mundshme ekonomike; shih <i>BPM6 13.14 dhe 13.18</i> gjegjësisht.			
* Në BPM6, rezultatet e K&ZH, të tilla si patentat dhe të drejtat e autorit, nuk trajtohen më si asete jo prodhuese. Blerjet dhe shitjet e drejtpërdrejta të këtyre produkteve nuk shfaqen më në llogarinë kapitale (si në BPM5, shih pjesën 312 dhe 358.), por klasifikohen si asete të prodhuara me transaksionet e regjistruara në shërbime (shërbimet R & D për patenta dhe të drejtat e autorit); shih <i>BPM6 Tabela 10.4 dhe BPM5 358</i> .			
* Transferet kapitale të lidhura me aktivizimin e garancioneve 'one-off' dhe supozimet e tjera të borxhit janë të specifikuar; shih <i>BPM6 8.42-8.45, 13.19, dhe Kutia 8.1</i> . Garancitë për një përdorim nuk janë diskutuar në BPM5.			
* Trashëgimitë e mëdha janë të trajtuar si transferet kapitale, në vend të transfereve rrjedhëse si në BPM5; shih <i>BPM6 13.30</i> .			
* Ndryshe nga BPM5, kërkesat e sigurimit mund të trajtohen si transfere kapitale në raste të veçanta të humbjeve katastrofike të jenë në pajtim me SNA; shih <i>BPM6 13.24</i> .			
Llogaria kapitale		A. Llogaria kapitale	
Blerjet (DR) / shitjet bruto (CR.) e aseteve jofinanciare jo prodhuese (N2)	←	2. Blerja / shitja e aseteve jofinanciare, prodhuese	
Transferet kapitale (D9)		1. Transferet kapitale	
Qeveria e përgjithshme		1.1 Qeveria e përgjithshme	
Falja e borxhit	←	1.1.1 Falja e borxhit	* Marrëveshja për dallimin në mes zbritjeve nga taksat dhe faljet e borxheve është paraqitur; shih <i>BPM6 9.10</i> .
Transferet e tjera kapitale <i>Nga të cilat: taksat kapitale (D91)</i>	←	1.1.2 Të tjera	
Korporatat financiare, korporatat jofinanciare, ekonomitë familjare, dhe OJSHEF-të		1.2. Sektorë të tjerë	
		1.2.1 Transferet e emigrantëve	* Gjësede personale, asetet financiare dhe detyrimet e personave që ndërrojnë vendbanim nuk janë të regjistruara më si transfere kapitale; <i>BPM6 13.30, 9.21-9.22 dhe 10.22(b); BPM5 352-353</i> .
Falja e borxhit	←	1.2.2 Falja e borxhit	* Marrëveshja për dallimin në mes zbritjeve nga taksat dhe faljet e borxheve është paraqitur; shih <i>BPM6 9.10</i> .
Transferet e tjera kapitale <i>Nga të cilat: taksat kapitale (D91)</i> <i>Nga të cilat: Ndërmjet ekonomive familjare</i>	←	1.2.3 Të tjera	* Ky zë bilancor plotësues është përdorur për të përpiluar remintancat, shih <i>BPM6 12.27</i> .
<i>Nga të cilat: për çdo zë bilancor në transferet kapitale: Transferet në OJSHEF-të</i>			* Të dhënat plotësuese për transferet kapitale në OJSHEF-të janë të nevojshme për të hartuar remintancat totale në OJSHEF-të, shih <i>BPM6 12.27 (c) dhe app. 5</i> .
Kreditimi neto(+) / huamarrjet neto (-) (bilanci nga llogaria rrjedhëse dhe kapitale) (B9)			Shuma e bilanceve të llogarisë rrjedhëse dhe kapitale, d.m.th, shuma e të gjitha kredive minus shuma e të gjitha debive në këto llogari, përfaqëson kreditimin neto (tepricën) ose huamarrjen neto (deficitin) nga ekonomia me të gjithë botën. Kjo është konceptualisht e barabartë me bilancin neto të llogarisë financiare; shih <i>BPM6 2.18 dhe tabelën 2.1</i> .
Llogaria financiare: Komente të përgjithshme			
* Në BPM6, banka qendrore zëvendëson autoritetet monetare si nën-sektor institucional, ndërsa autoritetet monetare mbeten një koncept thelbësor për përcaktimin e aseteve rezervë dhe një nën-sektor plotësues ku është relevante; shih <i>BPM6 4.70 dhe 6.66</i> . BPM6 paraqet një elaborim të sektorëve të tjerë në 'korporatat e tjera financiare dhe jofinanciare, ekonomitë familjare dhe OJSHEF-të'; shih <i>BPM6 kapitulli 4, tabela 4.2</i> .			
* Në BPM6, klasifikimi i detajuar i aseteve dhe detyrimeve financiare është i harmonizuar me SNA dhe Manualin mbi Statistikat Monetare dhe Financiare 2000 në aspektin e detajeve dhe terminologjisë; shih <i>BPM6 tabela 5.3</i> . Në komponentët standard BPM5, instrumentet janë të kombinuara dhe emra të ndryshëm për të përdorën në vende të ndryshme.			
* Në BPM6, shumat e vonuara janë mbajtur në asete/detyrime origjinal dhe janë identifikuar si zë bilancor memorandum nëse kanë të bëjë me financimin e veçantë (përndryshe klasifikohen si zë bilancor plotësues). Në BPM5, shumat e vonuara ri-klasifikohen nga asetet/detyrimet origjinal në asete/detyrime afatshkurtër dhe janë kërkuar si zë bilancor plotësues; shih <i>BPM6 5.99-5102, BPM6 8,58-8,59, dhe BPM5 453, .528-529</i> .			
* Marrëveshje për dallimin në mes uljeve të taksave dhe faljeve të borxheve është paraqitur; shih <i>BPM6 9.10</i> .			
* Asetet dhe detyrimet financiare të subjekteve (emigrantëve) që ndryshojnë vendbanimin përfshihen si ndryshime të tjera në vëllim; shih <i>BPM6 9,21-9,23</i> , ndryshe nga transaksionet në BPM5; shih <i>BPM5 354</i> .			
* Përmbytja e Shtojcës për Derivateve Financiare 2000 është e përfshirë. Si pasojë, kodimi i BPM5 Bilanci i Pagesave: Komponentët standard dhe detajet shitesë në këtë tabelë konvertimi nuk korrespondojnë me <i>BPM5 1993</i> por më tepër me kodimin e rishikuar të <i>Shtojcës të Derivateve Financiare 2000</i> .			

NDRYSHIMET NË TRAJTIM OSE KLASIFIKIME NË BPM6			
Zërat bilancor të BP-së			
BPM6 Bilanci i Pagesave: Komponentët standarde dhe Zërat Tjerë të përzgjedhur	Ri- kategorizimi	BPM5 Bilanci i Pagesave: Komponentet Standarde dhe detajet shitesë Zërat bilancor në shkronja kursive janë plotësues	Komente mbi Ndryshimet në Trajtim ose Sqarime
Zërat bilancor në shkronja kursive janë plotësues			
Investimet direkte: Komente të përgjithshme			
<p>* Në BPM6, investimet direkte janë paraqitur në bazë të Aseteve dhe Detyrimeve, ndryshe nga 'parimi direkt' në BPM5. Në komponentët standard, investimet direkte janë klasifikuar në bazë të marrëdhënieve ndërmjet investitorit dhe subjektit që merr investimet; shih BPM6 6.37-6.41. Kështu, nën 'investitorin direkt në ndërmarrjet investuese direkte' ekonomia raportuese e investitorit direkt regjistron asetet e investitorit direkt, dhe ekonomia raportuese e ndërmarrjeve investuese direkte regjistron (pasqyrën) detyrimet e ndërmarrjeve investuese direkte (qoftë në një marrëdhënie direkte ose indirekte); shih BPM6 6.37 (a). Sipas "ndërmarrjeve investuese direkte në investitorin direkt" (investimet anasjelltas) ekonomia raportuese e ndërmarrjeve investuese direkte regjistron asetet e ndërmarrjeve investuese direkte, dhe ekonomia raportuese e investitorit direkt regjistron detyrimet e investitorit direkt (qoftë në një marrëdhënie direkte ose indirekte); shih BPM6 6.37 (b). Në kuadër të zërit bilancor "Ndërmarrjet e ndërlidhura" ekonomia raportuese raporton asetet dhe detyrimet sipas rastit; shih BPM6 6.17.</p> <p>* Të dhënat mbi bazat direkte (directional basis) njihen si thelbësore për shumë qëllime; shih BPM6 .44-6.45. Detajet e nevojshme për të hartuar këto të dhëna janë paraqitur në BPM6 Kutia 6.4.</p> <p>* Në BPM6, Korniza për Marrëdhënie Investuese Direkte (KMID) është miratuar për identifikimin e marrëdhënieve investuese direkte; shih BPM6 6,8-6,18 dhe BPM6 Kutia 6.1. Pronësia e aksioneve të zakonshme është hequr nga përkufizimi operativ i investimeve direkte; shih BPM6 6.12 dhe 6.19. Në BPM6, kategoria e veçantë e investimeve në ndërmarrjet e ndërlidhura është e përfshirë, shih BPM6 6.17 (c). Mbulimi i marrëdhënieve investuese direkte për shkak të fuqisë votuese indirekte dhe ndërmarrjeve të ndërlidhura është elaboruar në BPM6 6.14.</p> <p>* Superdividendët trajtohen si një tërheqje e kapitalit; shih BPM6 8.23. Termi 'superdividendët' nuk është përdorur në BPM5, por trajtimi në BPM6 është në përputhje me parimet e përgjithshme të BPM5 (veçanërisht dividendët e likudimit; shih BPM5 290).</p> <p>* Rezervat teknike të sigurimit janë potencialisht të përfshira në investimet direkte; shih BPM6 6.27. Në BPM5, rezervat teknike të ndërmarrjeve të sigurimit janë të përjashtuara nga aksionet e investimeve direkte; shih BPM5 379.</p> <p>* Është paraqitur koncepti për fondet të transit (pass-through funds); shih BPM6 6,33-6,34. Është e inkurajuar që hartuesit në ekonomitë që kanë vlera të mëdha të fondeve të kalueshme të konsiderojnë përpilimin e të dhënave plotësuese për fondet në transit, bazuar në përkufizimet kombëtare.</p> <p>* Në BPM6, të gjithë borxhet midis llojeve të zgjedhura të korporatave të ndërlidhura financiare janë të përjashtuara nga investimet direkte, ndryshe nga BPM5, ku i ashtuqajturit Borxhi i Përhershëm u përfshi në investime direkte. Korporatat financiare për të cilët zbatohet kjo rregull janë bankat qendrore, korporatat e tjera depozitë marrëse përveç bankës qendrore, fondet e investimeve, dhe ndërmjetësit e tjerë financiarë me përjashtim të kompanive të sigurimit dhe fondeve pensionale; shih BPM6 6.28.</p>			
Llogaria financiare		B. Llogaria financiare	
Kreditimi neto (+) / huamarrjet neto (-) (bilanci nga llogaria financiare) (B9)			Bilanci neto i llogarisë financiare është i barabartë me rritjen neto të asetëve minus rritjen neto të detyrimeve. Ky nocion është konceptualisht i barabartë me bilancin neto të llogarisë rrjedhëse dhe kapitale; shih BPM6 2,17-2,18 dhe Tabelën 2.1.
Investimet direkte (FD)		1. Investimet direkte	
Blerja neto e asetëve financiare		1.1 Jashtë vendit	
Kapitali dhe fondi i investimeve në aksione (FSD)			
Kapitali përveç fitimit të ri-investuar		1.1.1 Kapitali aksionar	
Investitori direkt në ndërmarrjen investuese direkte	←	1.1.1.1 Kërkesat ndaj ndërmarrjeve simotra	
Ndërmarrja investuese direkte në investitorin direkt (investim anasjelltas)	←		* Në BPM5, ndërmarrjet e ndërlidhura nuk janë përmendur në mënyrë eksplicite.
Ndërmjet ndërmarrjeve të ndërlidhura		1.2 Në ekonominë raportuese	
<i>nëse vartësi kontrollues përfundimtarë është rezident</i>		1.2.1 Kapitali aksionar	
<i>nëse vartësi kontrollues përfundimtarë është jo-rezident</i>		1.2.1.1 Kërkesat ndaj investitorëve direkt	
<i>nëse vartësi kontrollues përfundimtarë është i panjohur</i>			
Blerja neto e asetëve financiare		1.1 Jashtë vendit	
Ri-investimi e fitimit	←	1.1.2 Fitimi i ri-investuar	* Në BPM6, terminologjia për hyrjen e llogarisë financiare është 'ri-investimi i fitimeve', për të dalluar atë nga "fitimi i ri-investuar", e cila vazhdon të përdoret për zërin bilancor korrespondues në të ardhurat primare; shih BPM6 8.15.
Nga të cilat: Aksionet ose njësitë e fondit të investimeve (F52D)			
Nga të cilat: Aksionet ose njësitë e fondit të tregut të parasë (F521D)			

DRYSHIMET NË TRAJTIM OSE KLASIFIKIME NË BPM6			
Zërat bilancor të BP-së			
BPM6 Bilanci i Pagesave: Komponentët standarde dhe Zërat Tjerë të përzgjedhur	Ri- kategorizimi	BPM5 Bilanci i Pagesave: Komponentet Standarde dhe detajet shesë Zërat bilancor në shkronja kursive janë plotësues	Komente mbi Ndryshimet në Trajtim ose Sqarime
Zërat bilancor në shkronja kursive janë plotësues			
Investimet direkte (FD) (vazhdim)			
Blerja neto e asetëve financiare Instrumentet e borxhit		1.1 Jashtë vendit 1.1.3 Kapitali tjetër	* Në BPM6, termi instrumentet e borxhit zëvendëson kapitelin tjetër.
Investitori direkt në ndërmarrjen investuese direkte	←	1.1.3.1 Kërkesat ndaj ndërmarrjeve simotra (affiliated enterprises)	* Siç është diskutuar më lartë, në BPM6, i gjithë borxhi midis llojeve të zgjedhura të ndërmarrjeve financiare simotra përjashtohet nga investimet direkte.
Ndërmarrja investuese direkte në investitorin direkt (investim anasjelltas)		1.1.3.1.1 Letra me vlerë të borxhit të lëshuara nga ndërmarrjet e simotra	
Ndërmjet ndërmarrjeve të ndërlidhura		1.1.3.1.2 Kërkesat tjera për ndërmarrjet simotra	
nëse vartësi kontrollues përfundimtarë është rezident nëse vartësi kontrollues përfundimtarë është jorezidentë nëse vartësi kontrollues përfundimtarë është i panjohur			* Në BPM5, ndërmarrjet e ndërlidhura nuk janë përmendur në mënyrë eksplicite.
		1.2 Në ekonominë raportuese	
<i>Nga të cilat: Letrat me vlerë të borxhit (F3D)</i>		1.2.3 Kapitali tjetër	
Investitori direkt në ndërmarrjen investuese direkte		1.2.3.1 Kërkesat ndaj investitorit direkt	* Siç është diskutuar më lartë, në BPM6, i gjithë borxh midis llojeve të zgjedhura korporatave të bijësuar financiare përjashtohet nga investimet direkte.
